




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



## Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Në bazë të vendimit nr 122 të dt.14.09.2012 të Kuvendit Komunal të Fushë-Kosovës dhe Pëlqimit nga MBPZHR nr. ZM-188/12 të dt.20.04.2012, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, shpallë :

### OFERTË PUBLIKE

|                                                                                                            |            |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| Referencë/Ref. Nr.                                                                                         | 856        |
| Data/Datum                                                                                                 | 23.09.2020 |
| KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE<br>DREJTORIA E ADMINISTRATIVES - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU |            |

Për dhënien në menaxhim të vendgjuetisë së përbashkët „Bjeshka”. Kushtet e dhënies së vendgjuetive të përbashkëta në menaxhim me qiranë janë rregulluar me Ligjin për Gjuetinë Nr.02/L-53, Nenit 34, paragrafët 34.1, 34.2, 34.3, 34.4, 34.5 dhe 34.6, si dhe aktin nënligjor-Udhëzimin Administrativ Nr.06/2009, Nenit 5. Kushtet e përcaktuara për këtë ofertë ( sipas UA Nr.06/2009 ) janë :

1. Dëshmia e regjistrimit të veprimtarisë;
2. Dëshmia për përvojën e punës në menaxhimin me kafshë të egra dhe gjueti (kjo vlen për menaxhuesit e deritanishëm të gjuetive-Shoqatave të gjuetisë) nga Federata e Gjahtarëve të Kosovës si dhe përshkrimi i rezultateve menaxhuese nga vitet paraprake;
3. Dëshmi për përvojën e punës në menaxhim dhe rezultatet e arritura në veprimtari të ngjashme-subjekte tjera juridike dhe fizike në: pylltari, bujqësi, veterinar, turizëm, ekologji
4. Dëshmi për shërbimin profesional që do të angazhohet në menaxhimin e gjuetisë, duke përfshi numrin e të punësuarve : gjuetarëve të kualifikuar, rojtarëve të gjuetisë, profesionistëve të angazhuar të florës dhe faunës;
5. Programi për synimet e menaxhimit dhe zhvillimit të vendgjuetisë: mbrojtja, ruajtja dhe shtimi i kafshëve të egra;
6. Dëshmi nga gjykata se personi përgjegjës nuk është dënuar dhe ndjekur penalisht.
7. Dëshmi që vërtetohet se subjekti ofertues nuk ka obligime financiare ndaj Agjencisë Tatimore të Kosovës;
8. Dëshmi për posedim të mjaftueshëm të mjeteve financiare për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

Afati për aplikim është 15 ditë nga dita e shpalljes;

Drejtoria  
Mehmet Gërguri

Materiali ofertues tërhiqet në Zyrën e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Kati ..II.....,  
Komuna e Fushë-Kosovës.

Afati për tërheqje të materialit ofertues sipas Udhëzimit Administrativ NR. 06/2009 është prej  
datës 23.09.2020 deri më datën 07.10.2020

Afati për dorëzimin e ofertave:07.10.2020 Ora 12.00h

Hapja e ofertave bëhet me datë 07.10.2020 në sallën e Kuvendit Ora 12.30h.